

## SHQIPËRIA DHE KOSOVA FIRMOSIN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Me rastin e ditës botërore të turizmit është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Unionit të Turizmit të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë. “Turizmi nuk njihet kufi prandaj duhet të bashkohemi dhe kontribuojmë në turizmin e të dy vendeve. Pandemia këtë vit ka shkaktuar dëme në sektorin e turizmit dhe qysh nga marsi turizmi është në pikën zero por shpresojmë që gradualisht ti kthehemi normalitetit”, ka thënë Kryetari i Unionit të Turizmit në Kosovë.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



## INXHINIERI SHQIPTAR NË KRYE TË KOMPANISË SË SUKSESSHME AUSTRIAKE

Historia e tij është histori emigrimi. Drini Mulla filloi krijimin e një kompanie inxhinierike në Melburn në vitin 1999 së bashku me dy miq të tij, ai nuk e mendoi kurrë se kompania e tij do të rritej aq shumë sa një ditë do të shndërrohej në një kompani ndërkombëtare. Qëllimi i tij është që të rritet në 1000 punonjës gjatë viteve të ardhshme.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



## REGJISTRIMI I SHQIPTARËVE JASHTË VENDIT

Agjencia Kombëtare e Diasporës sjell në një publikim të gjithë informacionin e nevojshëm për regjistrimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Revista elektronike jep informacion mbi çështjet që kanë të bëjnë me shtetësinë, procedurën e regjistrimit të shtetësisë si dhe procesin e regjistrimit të adresave të qytetarëve jashtë vendit, kuadrin ligjor rregullues, funksionimin e Shërbimit të Gjëndjes Civile në Shqipëri, rregullat e të dhënave personale për ruajtjen ose ndryshimin e tyre.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



## JAVA NË LAJME:

ECURIA E STRATEGJISË KOMBETARE TË DIASPORËS/  
PUBLIKOHET BULETINI INFORMATIV



AUSTRI/ NJË DOKUMENTAR PËR 4 PERSONALITETE  
TË DIASPORËS SHQIPTARE



GREQI/ AMBASADA SHQIPTARE NË ATHINË  
NJOFTON MASAT E REJA



## KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	105.20	106
EUR	123.70	124.30
CHF	114. <sup>20</sup>	115
GBP	135.60	136.80
DKK	16. <sup>30</sup>	16. <sup>70</sup>